



**UNIVERSITETI**

**I SHKENCAVE TË APLIKUARA**

———— FERIZAJ ————

**PLANI STRATEGJIK**

**I UNIVERSITETIT TË SHKENCAVE TË  
APLIKUARA NË FERIZAJ**

**2018 - 2020**

## **PËRMBAJTJA**

<b>PËRMBAJTJA</b> .....	ii
<b>SHKURTESAT</b> .....	iii
<b>DOKUMENTET E KONSULTUARA</b> .....	iv
<b>FJALA E REKTORIT</b> .....	1
<b>PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT STRATEGJIK 2018-2020</b> .....	1
<b>VIZIONI</b> .....	2
<b>MISIONI</b> .....	2
<b>VLERAT</b> .....	2
<b>STRATEGJIA E REALIZIMIT TË VIZIONIT</b> .....	3
<b>SYNIMET STRATEGJIKE</b> .....	4
<b>STRATEGJITË TEMATIKE</b> .....	8
<b>RESURSET</b> .....	15
<b>BUXHETI</b> .....	18

## SHKURTESAT

USHAF - Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj

MASHT - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

PA - Parlamenti Studentor

TKP - Treguesit Kryesorë të Performancës

## **DOKUMENTET E KONSULTUARA**

Ligji për Arsimin e Lartë i Republikës së Kosovës, 2010;

Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë, 2017 - 2021;

Statuti i Përkohshëm i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj;

Studimi i arsyeshmërisë për themelimin e Universitetit të Shkencave të Aplikuara të Kosovës, 2015;

Plani Strategjik i University of Edinburgh, 2012 - 2016;

Plani Strategjik i James Medison University, 2014 - 2020.

## FJALA E REKTORIT

Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj është institucion i vetëm publik në Kosovë i specializuar në shkencë të aplikuara, me qëllim të edukimit të orientuar nga praktika dhe i lidhur me tregun e punës. Ky fakt, jo vetëm që bën UShAF-in si institucion të preferuar për të rinjtë kosovarë, por edhe ia shton përgjegjësitë dhe obligimet vetë institucionit për ofrimin e shërbimeve sa më cilësore në përmbushje të kërkesave të studentëve, komunitetit lokal dhe rajonal dhe mbi të gjitha bizneseve, si njëri ndër akterët më të rëndësishëm të UShAF-it.

Edhe pse i ri si universitet, tradita e punës akademike dhe shkencore në Ferizaj daton nga viti 1976, kur Kuvendi i Kosovës me Vendimin 692-2 themeloi Qendrën e Shkollimit të Lartë.

Numri në rritje i studentëve, me një numër relativisht të vogël të programeve (gjithsej katër programe bachelor), rritë sfidat dhe përgjegjësitë ndaj vetë UShAF-it për zhvillim të vazhdueshëm për të mbajtur hapin dhe plotësuar nevojat e bizneseve rajonale si dhe atyre kosovare.

Brenda një periudhe shumë të shkurtë që nga themelimi, UShAF ka ndërtuar një partneritet të mirë me më shumë se 40 biznese, me të cilat edhe ka nënshkruar marrëveshje të bashkëpunimit. Gjithashtu, UShAF gjatë kësaj kohe ka filluar bashkëpunimin me shumë universitete ndërkombëtare, me të cilat edhe ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, është përfitues i dy projekteve Erasmus+ për ndërtimin e kapaciteteve, si dhe tri projekteve të mobilitetit të studentëve dhe stafit në kuadër të projektit Erasmus+.

Pas analizave dhe nevojave të bëra gjatë hartimit të studimit të arsyeshmërisë për themelimin e UShAF, dhe analizave të fundit brenda UShAF-it, është realizuar dokumenti "Plani Strategjik i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj 2018-2020", i cili do të adresojë gjatë tri viteve në vijim çështjet që lidhen me ngritjen e cilësisë në të gjitha shërbimet e UShAF-it.

Kjo Strategji, identifikon dhe adreson masat dhe instrumentet që UShAF, si institucioni më i ri i arsimit të lartë në Kosovë duhet të ndërmarrë që zhvillimi akademik të jetë i lidhur më ngushtë me tregun e punës, si akademike ashtu edhe ato profesionale, si dhe ndërkombëtarizimin e Universitetit dhe nevojat e shoqërisë në tërësi.

Menaxhmenti i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj është shumë i përkushtuar të zbatojë këtë Strategji, për të arritur rezultate të krahasueshme në nivel ndërkombëtar, si dhe të kontribuojë në zhvillimin socio-ekonomik të Republikës së Kosovës.

Me respekt,  
Prof. Dr. Agron Bajraktari, rektor



## PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT STRATEGJIK 2018-2020

Në mbledhjen e Këshillit Drejtues të UShAF-it të datës 15 Mars 2017 është marrë vendim për hartimin e Planit Strategjik të UShAF 2018-2020 dhe ka emëruar Grupin Punues të përbërë prej përfaqësuesve të stafit menaxherial, akademik dhe administrativ. Të gjitha aktivitetet zhvillimore të UShAF-it do të udhëhiqen nga ky dokument, i cili njëkohësisht do të jetë edhe tregues i performancës mbi bazën e monitorimit dhe rishikimit vjetor të tij.

Grupi Punues fillimisht ka kompletuar portfolion e gjithë dokumentacionit relevant për hartimin e planit strategjik me fokus në dokumentet strategjike të MASHT për arsimin e lartë (PSAK 2017-2021), dokumentet strategjike të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe Universitetit të Gjakovës "Haxhi Zeka", dokumente ndërkombëtare të arsimit të lartë, etj. Gjithashtu, Grupi Punues ka shfrytëzuar modelin e Planit Strategjik të University of Edinburgh 2012-2016, plan ky i cili i është përshtatur shumë specifikave të Univesitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, si në formë e strukturë, ashtu edhe në përmbajtje.

Për analizën e gjendjes në UShAF është shfrytëzuar metoda e SWOT dhe ajo është përqendruar në pesë fusha kryesore: 1) Mësimi dhe hulumtimi; 2) Marrëdhëniet ndërkombëtare 3) Sigurimi i cilësisë; 4) Administrata; 4) Financat; 5) Industria dhe puna praktike. (Shtojca A. SWOT analizat sektoriale)

Me datë 27.12.2019, Këshilli drejtues në mbledhjen e tij ka marr vendim të rishikoj strategjinë për periudhën e mbetur dhe ka formuar Grupin Punues në përbërje:

Prof.As.Dr. Samet Dalipi	Këshilli Drejtues	Kryetar
Prof.Dr. Bujar Pira	Menaxhmenti	Anëtar
Armend Hysa	Administrata	Anëtar
Prof.As.Dr. Petrit Hasanaj	Stafi akademik	Anëtar
Rinidon Bislimi	Alumni	Anëtar
Donjeta Sadriu	Parlamenti Studentor	Anëtare
Arianit Kastrati	Bordi Industrial	Anëtar

Grupi ka mbajtur tri takime pune dhe konsultative në të cilat janë rishikuar Vizioni, Misioni dhe Vlerat e Universitetit si dhe janë rishikuar të gjitha synimet strategjike the ato funksionale (tematike).

Grupi Punues falënderon të gjithë ata që kontribuan në çfarëdo mënyre në hartimin e Planit Strategjik të UShAF-it duke shpresuar që kjo strategji do të avancojë edhe marrëdhëniet e Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj me bizneset dhe asociacionet e bizneseve, partnerëve vendor dhe ndërkombëtarë, institucioneve qeveritare si dhe institucioneve të tjera.

Prof.As. Dr. Samet Dalipi  
Kryesues i Grupit Punues

## VIZIONI

Model kombëtar i një universiteti modern, inovativ dhe i edukimit integruar, ku praktika plotëson teorinë dhe zhvillohen aftësi profesionale e hulumtuese për të mirën e shoqërisë.

## MISIONI


Jemi të përkushtuar të ofrojmë arsim cilësor, që të përgatisim profesionistë të kualifikuar, hulumtues të përkushtuar dhe qytetarë të edukuar e të përgjegjshëm për të zhvilluar një karrierë profesionale dhe për të udhëhequr një jetë produktive.

## VLERAT

- **Të mësuarit:** Universiteti vlerëson arsimin, i cili është i orientuar drejt punësimit, balancon teorinë dhe praktikën, fokuson mësimin aktiv dhe të menduarit kritik dhe nxitë përgjegjësinë dhe dëshirën për mësimin tërë jetësorë.
- **Etika:** Universiteti trajton dinjitetin e secilit anëtar të tij me respekt, ndershmëri, barazi dhe integritet, duke përkrahur lirinë akademike.
- **Bashkëpunimi:** Ndërtimi i partneriteteve me studentë, alumni, biznese dhe industri, institucione qeveritare vendore dhe ndërkombëtare, Agjencinë e Akreditimit dhe komunitetit të cilit Universiteti i shërben.
- **Përsosmëria:** Ne përpiqemi të jemi të përsosur dhe ekselent në edukim, krijimtari shkencore dhe inovacione.
- **Diversiteti:** Përqafojmë idetë, besimet, kulturat dhe etnitetet e ndryshme.



## STRATEGJIA E REALIZIMIT TË VIZIONIT



Synimet strategjike të Universitetit janë: përsosmëria në arsim, në punë praktike dhe hulumtim, si dhe në inovacion. Gjashtë shtyllat (temat) tona strategjike funksionale janë orientim për Universitetin në arritjen e këtyre synimeve. Angazhimi i Universiteti ndaj Planit Strategjik është kolektiv dhe gjithëpërfshirës ku i gjithë Universiteti është përgjegjës për realizimin e tij.

Për secilin nga synimet strategjike janë identifikuar edhe qëllimet, objektivat, aktivitetet (apo strategjitë) dhe treguesit kryesorë të performancës (TKP), si dhe caqet indikative. Universiteti do të monitoroj dhe raportoj realizimin e Planit Strategjik përmes treguesve kryesorë të performancës (TKP) dhe caqet vjetore. Universiteti vlerëson që, me kalimin e kohës, qëllimet dhe objektivat për secilin nga synimet strategjike do të mbeten të njëjta, por, varësisht nga ndryshimet në mjedisin ku veprojmë do të ndryshojnë vetëm (TKP) dhe treguesit tjerë.

## SYNIMET STRATEGJIKE

Synimet strategjike janë: përsosmëria në arsim, punë praktike, hulumtim, si dhe në inovacion.

<b>Përsosmëria në Arsim</b>
Ky synim strategjik përfshin cilësinë, thellësinë dhe rëndësinë e të mësuarit dhe mësimdhënies së studentëve universitarë dhe atyre profesionalë.
<p><b>Qëllimi</b></p> <p>Të nxisim te studentët tanë dëshirën e përhershme për njohuri dhe mësim si dhe të inkurajojmë një zhvillim profesional, të pavarur dhe inovativ , si dhe aspirata për të arritur sukses brenda dhe përtej Universitetit.</p>
<p><b>Objektivat</b></p> <p>Për të realizuar qëllimin, ne do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përdorim kapacitetet dhe aftësitë tona akademike, profesionale dhe personale udhëheqëse për të mbështetur mësimdhënien;</li> <li>• udhëzojmë dhe mbështesim studentët tanë nëpërmjet zhvillimit të programeve shkencore dhe aplikative/profesional;</li> <li>• zhvillojmë aftësinë e secilit student për të mësuar përmes kërkimit, studimit të thelluar dhe praktikës, veçanërisht në nivelin pasuniversitar;</li> <li>• nxisim një klimë, në të cilën mësimi vlerësohet shumë;</li> <li>• përmirësojmë në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e mësimdhënies duke pasur studentin në qendër të mësimiit</li> <li>• integrojmë vlerat tona në të gjitha programet e studimit dhe pajisim studentët tanë me shkathtësi për të konkurruar në tregun vendor dhe global të punës.</li> </ul>
<p><b>Strategjitë</b></p> <p>Ne do t'i realizojmë objektivat duke:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përdorur qasjen e re të njohur si "Udhëheqësi Personal" për të udhëhequr planin akademik dhe progresin arsimor të çdo studenti, duke i përkrahur ata për të marrë pronësinë e të mësuarit dhe zhvillimit profesional për të planifikuar karrierën ardhshme e tyre të;</li> <li>• futur fleksibilitet të vazhdueshëm në modelet e studimit/mësimnxënies, duke ruajtur integritetin dhe strukturën e programit, dhe duke u mundësuar studentëve që të pauzojnë studimet e tyre në momente të caktuara, pastaj të mbështesim kthimin e tyre, etj.;</li> <li>• motivuar dhe përgatitur studentët tanë për të fituar një përvojë jashtë vendit si pjesë e edukimit tyre universitar (si punë sezonale ose vullnetare) ose për të bërë punë praktike (të bazuar në punë në industri) , duke i kuptuar përfitimet që kjo sjellë në zhvillimin e tyre arsimor, personal dhe profesional;</li> <li>• bërë të mundur që studentët tanë pasuniversitarë të jenë të angazhuar në hulumtime, gjenerim dhe shkëmbim të njohurive, adresimin e problemeve të industrisë etj.;</li> <li>• organizuar trajnime dhe punëtori për të gjithë mësimdhënësit për metodologjitë dhe praktikatat e reja të mësimdhënies</li> <li>• punuar me punëdhënësit, trupat profesionale, alumni dhe akterë të tjerë për të siguruar që programet tona të studimit të jenë të përgjegjshme ndaj nevojës, duke nxjerrë të diplomuar me attribute dhe ekspertizë të vlefshme për ekonominë në veçanti dhe shoqërinë në përgjithësi;</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• bërë të mundur që stafi ynë të përqafojë teknologjitë e reja, si pjesë e rritjes së përvojës së mësimdhënies.</li> </ul>
<p><b>TKP</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përqindja e të diplomuarve që arrijnë një rezultat të suksesshëm (gradë, transferim ose ndonjë çmim tjetër),</li> <li>• Punësueshmëria e studenteve apo qasja e lehte e tyre në tregun e punës,</li> <li>• Pjesëmarrja e studentëve në punë praktikë në institucione dhe ndërmarrje ndërkombëtare ,</li> <li>• Pjesëmarrja e studentëve, sidomos të atyre master, në zgjidhjen e problemeve të industrisë.</li> </ul> <p><b>Caqet</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritja e numri të të diplomuarve për 20%</li> <li>• Rritja e numri të pjesëmarrësve në panairin e punës së USHAF për 20%</li> <li>• Rritja e interesimit të studentëve për të marrë pjesë në punë praktike</li> <li>• Involvimi i studentëve master në zgjidhjen e së paku dy problemeve të industrisë</li> </ul>

<p><b>Përsosmëria në punë praktike dhe hulumtim</b></p>
<p>Puna laboratorike për nevoja të hulumtimeve shkencore dhe për nevoja të industrisë dhe komunitetit në përgjithësi përbënë njërën prej shtyllave kryesore me të cilat USHAF synon të bëjë ndryshimin e pritur në tregun e arsimit të lartë në vend dhe me gjerë. Ky synim përfshin spektrin dhe cilësinë e hulumtimit dhe punës laboratorike në USHAF duke involvuar si stafin ashtu edhe studentët e në veçanti ata të studimeve pasdiplomike.</p>
<p><b>Qëllimi</b></p> <p>Krijimi i një komuniteti të suksesshëm dhe interaktiv hulumtues që gjeneron ide dhe risi në shkencë dhe në aplikimin e saj, krijon fusha të reja të dijes dhe bënë përparim në zhvillimin shoqëror, kulturor, mjedisor, shëndetësor dhe mirëqenies së Kosovës .</p>
<p><b>Objektivat</b></p> <p>Për të realizuar qëllimin, ne do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• kalojmë përtej kufijve të disiplinave tradicionale të hulumtimit dhe zhvillojmë fusha të reja të hulumtimit;</li> <li>• hapim institutin kërkimor dhe aplikativ për të zhvilluar mundësitë e hulumtimit shkencor si dhe aplikimit të tij në praktikë;</li> <li>• gjenerojmë dhe zhvillojmë një grup të hulumtuesve të së ardhmes.</li> <li>• përkrahjen financiare të aktiviteteve kërkimore/shkencore të stafit akademik dhe studentëve</li> </ul>
<p><b>Strategjitë</b></p> <p>Ne do t'i realizojmë objektivat duke:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxitur qasje të reja për hulumtimet ndër-disiplinore, duke përfshirë inkurajimin e bashkëpunimeve kërkimore ndërkombëtare;</li> <li>• formuar dhe siguruar partneritete strategjike me komunitetin e biznesit për financimin e hulumtimeve dhe punës praktike;</li> <li>• përmirësuar pozicionimin tonë për të konkurruar me sukses në projektet e ndryshme evropiane dhe më gjerë, sikurse është Horizonti 2020, duke mbështetur stafin tonë për të qenë pjesë e konzorciumeve të suksesshme ndërkombëtare;</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• gjeneruar bursa dhe forma tjera të përkrahjes financiare të hulumtimeve;</li> <li>• rritur profilin e aktivitetit dhe ekspertizës sonë kërkimore dhe profesionale, si në vend ashtu edhe në nivel ndërkombëtar, duke shfrytëzuar infrastrukturën laboratorike në Universitet;</li> <li>• pajisur laboratorin e Universitet me pajisjet me moderne laboratorike për të mbështetur hulumtimin dhe punën praktike si dhe për të përkrahur aktivitetet e ndryshme komerciale për nevoja të bizneseve dhe shoqërisë Kosovare në përgjithësi.</li> </ul>
<p><b>TKP</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i punimeve kërkimore të stafit akademik dhe studentëve të universitetit të publikuara në revista ndërkombëtare si bashkë-autorë</li> <li>• Pjesëmarrja në konferenca te ndryshme ndërkombëtare, ku do te shfaqen njohuritë e fituara praktike, përmes hulumtimeve te ndryshme.</li> <li>• Përmasimi i rangimit të Universitetit në ranglistën e universiteteve në Webometrics</li> <li>• Organizimi i suksesshëm i konferencave ndërkombëtare</li> <li>• Thellimi i bashkëpunimit ndërmjet mësimitdhënësve dhe studenteve ne punët e tyre kërkimore shkencore.</li> </ul> <p><b>Caqet</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritja e numrit të publikimeve në revista dhe konferenca ndërkombëtare të punimeve të stafit akademik dhe studentëve</li> <li>• Themelimi i fondit për kërkim në universitet për përkrahje të punës hulumtues të stafit dhe studentëve</li> <li>• Themelimi i institutit dhe krijimi i një qendre referente laboratorike në Kosovë dhe rajon</li> <li>• Organizimi i së paku një konference në bashkëpunim me institucionet, universitetet ndërkombëtare deri në vitin 2020</li> <li>• Së paku pesë hulumtime të përbashkëta ne mes studentëve dhe mësimitdhënësve dhe së paku dy publikime të përbashkëta</li> </ul>

<p><b>Përsosmëria në inovacion</b></p> <p>Rrugët tona të përcaktuara mirë për shkëmbimin e njohurive përfshijnë edhe publikimet që dalin nga hulumtimi, si dhe nga njohuritë dhe aftësitë që të diplomuarit marrin me vete kur t'i përfundojnë studimet. Ky synim, i cili besojmë që na dallon neve nga të gjitha universitetet tjera, do të jetë bashkëpunimi me biznese dhe inovacioni. Hollësi të mëtejshme mbi ndikimin më të gjerë të aktiviteteve të inovacionit në Universitet dhe bashkëpunimit me biznese ofrohen në seksionin Bashkëpunimi me industrinë (institutet, punëtoritë dhe labotatoret).</p>
<p><b>Qëllimi</b></p> <p>Të sigurojmë që njohuritë, idetë, aftësitë dhe ekspertiza jonë transformohet në mendime dhe këshilla, risi, pronë intelektuale, ndërmarrje dhe pasuri të universitetit</p>

### **Objektivat**

Për të realizuar qëllimin, ne do të:

- nxisim inovacione dhe kërkojmë aplikime të reja të shkencës, nga të cilat përfiton ekonomia lokale dhe duke ndërtuar profilin tonë dhe njëkohësisht të hyrat vetanake;
- identifikojmë mënyrat më të mira për kthimin e ideve nga studentët dhe stafi në realitet tregtar;
- konsolidojmë reputacionin tonë si një partner i zgjedhur për biznese dhe si një lider institucional akademik në Kosovë në bashkëpunimin me industrinë;
- maksimizojmë përfitimet financiare, si dhe përfitimet tjera që rrjedhin nga shkëmbimi i njohurive dhe praktikave me industrinë;
- rrisim ndikimin tonë në kulturën, shëndetin dhe mirëqenien e komunitetit lokal dhe atij nacional.

### **Strategjitë**

Ne do t'i realizojmë objektivat duke:

- frymëzuar studentët dhe stafin për të fituar dhe përdorur aftësitë e tyre ndërmarrëse dhe menaxheriale;
- nxitur studentët dhe stafin për t'u angazhuar me publikun dhe akterët e rëndësishëm në industri, politikë dhe praktikë, si pjesë e hulumtimit të tyre, me fokus në identifikimin e kërkesave të ardhshme kërkimore;
- nxitur shkëmbimin e stafit inovator me industrinë, institucionet kulturore dhe ofruesit e shërbimeve publike;
- kapitalizuar mbi pronën intelektuale;
- punuar me universitetet e tjera në Kosovë për të lehtësuar bashkëpunimin me industrinë, në të njëjtën kohë, duke ruajtur statusin tonë si udhëheqës në marrëdhëniet me industrinë;
- zgjeruar gamën tonë të programeve të vazhdueshme të zhvillimit personal dhe profesional;
- u angazhuar në mënyrë profesionale, etike dhe të koordinuar me partnerët komercial dhe jo-tregtar;
- forcuar lidhjet me biznesin dhe komunitetin financiar, për të mbështetur inovacionin dhe aktivitetet tona komerciale.

### **TKP**

- Numri i inovacioneve, patenteve, licencave dhe formacioni i kompanive të reja.
- Numri i produkteve të reja të dizajnura nga studentët dhe stafi akademik
- Pjesëmarrja e aktiv i bizneseve anëtarë të bordit industrial në takime
- Realizimi i të hyrave vetanake nga aktivitetet komerciale

### **Caqet**

- Zhvillimi i së paku pesë produkteve apo shërbimeve inovative për bizneset vendore.
- Së paku 50% e anëtarëve të bordit industrial marrin pjesë në takime të rregullta
- 25% e të hyrave vetanake të universitetit realizohen nga aktivitetet komerciale

Vërejtje: USHAF posedon infrastrukturën (objektet) për të mundësuar instalimin e pajisjeve të ndryshme laboratorike të përmasave industriale.

## STRATEGJITË TEMATIKE

Qasja jonë për arritjen e qëllimeve tona strategjike është formuar nga gjashtë strategjitë tona tematike (funksionale).

<b>Studentët dhe përvoja studentore</b>
<p>Kjo strategji tematike ndërtohet mbi qëllimin strategjik për përsosmëri në arsim dhe mbulon disa nga mundësitë që u ofrohen studentëve dhe mbështetjen që ne u ofrojmë për të kontribuar në përvojën unike të studentëve.</p>
<p><b>Qëllimi</b> Të krijojmë mundësi që studentët të marrin përvojë të veçantë si dhe përgatitja e tyre të nisë dhe të plotësohet përmes marrëdhënieve të mira me Universitetin gjatë dhe pas studimeve</p>
<p><b>Objektivat</b> Për të realizuar qëllimin, ne do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• kombinojmë përsosmërinë tonë të mësimdhënies me një përvojë të veçantë të studentëve, si në kampus dhe ashtu edhe jashtë tij;</li> <li>• gjallërojmë dhe nxisim te studentët dhe alumni një ndjenjë të fortë të përkatësisë me Universitetin;</li> <li>• rrisim përvojën e studentëve duke i involvuar në vendimmarrje në të gjitha çështjet, të cilat kanë të bëjnë me ta, si: format e mësimi, shërbimet e studentëve, aktivitetet studentore, etj.;</li> <li>• promovojmë shëndetin, mirëqenien dhe sigurinë e studentëve;</li> <li>• pajisim të diplomuarit tanë me ekspertizën e nevojshme me të cilën ata arrijnë potencialin e tyre të plotë në punë dhe shoqëri.</li> <li>• Rritja e ndërveprimit të të diplomuarve (Alumni) dhe Universitetit si vegëz për zhvillimin e programeve të studimit</li> </ul>
<p><b>Strategjitë</b> Ne do të arrijmë objektivat duke:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• siguruar që stafi ynë të ketë shkathhtësi, aftësi dhe njohuri për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive rrethanave, përvojës, pritjeve dhe kërkesave të studentëve tanë;</li> <li>• rritur interesimin e studentëve për mundësi të ndryshme si: studimi jashtë vendit, mësimi i një gjuhe të huaj, ose përmbushja e rolit “student ambasador”, etj.;</li> <li>• promovuar dhe njohur pjesëmarrjen e studentëve në aktivitete brenda dhe jashtë-kurrikulare;</li> <li>• ofruar shërbime argëtuese dhe sportive, duke i mbështetur studentët tanë dhe klubet e ndryshme, si ato sportive, etj.;</li> <li>• ndërmjetësuar partneritet të qëndrueshëm strategjik ndërmjet Universitetit, industrisë, Alumnit dhe institucioneve tjera relevante për të rritur zhvillimin e vazhdueshëm profesional;</li> <li>• përmirësuar bashkëveprimin ndërmjet administratës, shërbimeve të studentëve, shërbimeve të mbështetjes së studentëve dhe fakulteteve në nivel universitar për të njohur më mirë nevojat dhe pritjet e studentëve, studentëve të ardhshëm dhe Alumni;</li> <li>• krijimi i lidhjeve të gjalla ne mes të Alumnit, Universitetit dhe komunitetit të biznesit, të cilat janë reciprokisht të dobishme dhe që sjellin pasuri në përvojën tonë studentore.</li> <li>• Plotësime i përvojës së studentëve në mënyrë që tranzicioni universitet-treg i punës të jetë sa më i lehtë.</li> </ul>

<p><b>TKP</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kënaqshmëria e studentëve me shërbimet në universitet</li> <li>• Numri i të angazhuarve në rrjetin e Alumni-t</li> <li>• Përqindja e të diplomuarve (studime universitare dhe pasuniversitare) në nivelin e diplomës ose studime të mëtejshme.</li> <li>• Numri i organeve vendimmarrëse të universitetit ku studentët janë të përfaqësuar</li> </ul> <p><b>Caqet</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritja përqindjes së studentëve të kënaqur me shërbimet dhe aktivitetet studentore.</li> <li>• Rritja e interesimit të studentëve për të studime jashtë vendit.</li> <li>• Pjesëmarrja e studentëve në të gjitha organet vendimmarrëse</li> </ul>
---

<p><b>Ndërkombëtarizimi dhe Globalizimi</b></p>
<p>Në këtë strategji tematike ne theksojmë qasjen për arritjen e ndikimit global. Ky seksion plotëson tre synimet strategjike, por gjithashtu lidhet me strategjitë tematike: Studentët dhe përvoja studentore dhe Sigurimin e cilësisë.</p>
<p><b>Qëllimi</b></p> <p>Të jemi universitet i karakterit ndërkombëtar, me programe dhe projekte, nga e cila do të përfitojnë universiteti, studentët, stafi dhe shoqëria në tërësi.</p>
<p><b>Objektivat</b></p> <p>Për të realizuar qëllimin, ne do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zgjerojmë ndërkombëtarizimin e universitetit;</li> <li>• ngrisim kapacitetet tona që të jemi në hap me zhvillimeve edukative dhe shkencore ndërkombëtare</li> <li>• rrisim përvojën ndërkombëtare të studentëve dhe stafit;</li> <li>• promovojmë qytetarinë globale.</li> </ul>
<p><b>Strategjitë</b></p> <p>Ne do të arrijmë objektivat duke:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• rritur numrin e bashkëpunimeve me universitetet dhe institucionet e ndryshme ndërkombëtare;</li> <li>• përfshirë internacionalizimin në të gjitha fushat e veprimtarisë së Universitetit;</li> <li>• përfshirë zhvillimin e kurrikulave të krahasueshme ndërkombëtarësh;</li> <li>• promovuar qytetarinë globale përmes mobiliteti të stafit dhe studentëve si dhe ligjëruesve ndërkombëtar vizitor;</li> <li>• shkëmbyer njohuritë me partnerët ndërkombëtarë duke promovuar qasje inovative për bashkëpunimin akademik ndërdisiplinor;</li> <li>• mbështetur dhe promovuar njohjen e vlerës së mobilitetit ndërkombëtar, raporteve ndërkulturore dhe shumë-gjuhësinë për të gjithë studentët dhe stafin e universitetit;</li> <li>• zgjeruar dhe përkrahur çasjen në bursat ndërkombëtare të studimeve dhe mobiliteteve të stafit dhe studentëve.</li> </ul>

#### **TKP**

- Anëtarësimi së paku në një nga asociacionet ndërkombëtare të universiteteve
- Nënshkrimi i marrëveshjeve me institucione ndërkombëtare
- Partner në projekte ndërkombëtare të llojit Erasmus+, etj.
- Shkëmbimi i studenteve, stafit me universitetet ndërkombëtare.
- Numri i ligjëruesve mysafir (guest lecturer) në universitet

#### **Caqet**

- Anëtarësimi në njëren nga asociacionet e universiteteve në vitin e parë të implementimit
- Rritja e numrit të marrëveshjeve ndërkombëtare për 20% deri në fund të vitit 2020
- Aplikim në së paku dy projekte të ngritjes së kapaciteteve (KA2) dhe Mobilitetit (KA1) të programit Erasmus+ në secilin vit
- Pjesëmarrja e së paku 10 mësimitdhënësve dhe studentëve në mobilitete ndërkombëtare (në shkuarje dhe ardhje) deri në fund të vitit 2020
- Pjesëmarrja së paku një mësimitdhënësi ndërkombëtar në ligjërata me student dhe staf akademik të universitetit.

#### **Sigurimi i cilësisë**

Kjo strategji tematike i definon aktivitetet e Universitetit, të cilat kanë të bëjnë me programet e studimit dhe akreditimin e tyre, sigurimin e cilësisë në harmoni me kërkesat e Agjencisë së Akreditimit dhe standardeve të brendshme të Universitetit.

#### **Qëllimi**

Vendosja e planeve, mekanizmave dhe sistemeve gjithëpërfshirëse për të monitoruar dhe vlerësuar cilësinë e ofritit të të gjitha shërbimeve dhe programeve të Universitetit në funksion të përmirësimit të mësimnxënies.

#### **Objektivat**

Për të realizuar qëllimin, ne do të:

- sigurojmë veten dhe palët e interesuara që politikat, procedurat dhe proceset e sigurimit të cilësisë janë duke funksionuar në mënyrë efektive në të gjitha fushat e universitetit;
- përmisojmë vazhdimisht planet dhe mekanizmat e sigurimit të cilësisë përmes rishikimeve, riorganizimit dhe rishikimit të praktikave të sigurimit të cilësisë, politikave, rregulloreve dhe procedurave mbështetëse të tyre;
- identifikojmë përparësitë tona, si dhe dobësitë të cilat duhet të kërkojnë vëmendjen për përmirësim të vazhdueshëm në afat të shkurtër, të mesëm dhe afatgjatë;
- ndërmarrim një vetëvlerësim periodik në aspektin e aktiviteve, mësimnxënies dhe mësimdhënies, angazhimit të komunitetit dhe shërbimet mbështetëse të studentëve, etj.;
- krahasohemi me praktikën më të mira ndërkombëtare të sigurimit të cilësisë.



### **Strategjitë**

Ne do të arrijmë objektivat:

- duke involvuar të gjitha palët e interesit në proceset e brendshme dhe të jashtme të sigurimit të cilësisë sikurse, bizneset, alumni dhe studentët, etj
- duke krijuar mekanizma te besueshëm të vlerësimit të cilësisë;
- duke përmirësuar proceset e brendshme në mësimdhënie dhe mesimnxënine përmes hulumtimit me student dhe staff (akademik dhe administrativ),
- përmes vlerësimit të jashtëm të sigurimit të cilësisë së programeve të studimit dhe punësimit të të diplomuarve përmes hulumtimit me punëdhënësit dhe Alumni
- përmes monitorimit të vazhdueshëm të indikatorëve kyç të performancës së universitetit në përgjithësi dhe programeve ne veçanti
- duke marrë pjesë të konferenca dhe forume ndërkombëtare të sigurimit të cilësisë

### **TKP**

- Akreditimi i suksesshëm i programeve të reja dhe riakreditimi i atyre ekzistuese.
- Gatishmëria e akterëve të brendshëm dhe jashtëm në pjesëmarrje në proceset e sigurimit të cilësisë në universitet,
- Realizimi i pritshmërive dhe nevojave te studenteve, drejt zhvillimit te tyre profesional,

### **Caqet**

- Vlerësimi i suksesshëm i programeve të riakredituera në universitet
- Rritja e kalueshmërisë së studentëve nga viti në vit për 20%
- Pjesëmarrja e së paku 10 punëdhënësve në hulumtime për programe

### **Bashkëpunimi me industrinë (institutet, punëtoritë, qendrat e trajnimeve dhe laboratorët)**

Kjo strategji tematike i definon aktivitetet e Universitetit, të cilat kanë të bëjnë me punën praktike dhe laboratorike të studentëve dhe mësimdhënësve, si dhe bashkëpunimin me industri dhe komunitet në ngritjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të përgatitjes profesionale. Kjo strategji tematike lidhet ngushtë me dy synimet strategjike të Përsosmërisë në Inovacione dhe Përsosmëria në punë praktike dhe hulumtim.

### **Qëllimi**

Zhvillimi i partneriteteve dhe bashkëpunimeve afatgjata produktive që rrisin pozicionin vendor dhe ndërkombëtar dhe te siguroj pavarësi dhe qëndrueshmëri financiare te Universitetit.

### **Objektivat**

Për të përmbushur qëllimin, ne do të:

- pozicionojmë veten si institucion unik për të krijuar dhe shfrytëzuar mundësitë e partneritetit me komunitetin e biznesit;
- rrisim kapacitetet moderne laboratorike, teknologjike dhe infrastrukturore si dhe atyre njerëzore (profesionale);
- sigurojmë mundësinë e ndërlidhjes së mësimin teorik me atë praktik përmes punës praktike (internship) në industri;
- ndërtojmë një qendër të trajnimit dhe kualifikimit profesional dhe edukativ.

